



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Ac.nr.10227/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Gëzim Llluni kryetar, Naim Mehulli dhe Liridon Maloku, në çështjen juridike-kontestimore të paditësve: S.K., R.B., R.H., S.M., H. D. dhe V.D. që të gjithë nga R., të përfaqësuar sipas autorizimit nga A.M. avokat nga R., kundër të paditurës Komuna e Rahovecit-Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson përfaqësuesi ligjor B.O., për shkak të kompensimit të ushqimit gjatë punës, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, C.nr.531/2020, i datës 19.05.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 03.10.2022, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës Komuna e Rahovecit-Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, C.nr.531/20, i datës 19.05.2021, VËRTETOHET.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në dispozitiv është vendosur si vijon: *“Pjesërisht aprovohet padia dhe kërkesëpadija e paditësve S.K., R.B., R.H., S. M., H.D. dhe V. D. si dhe Detyrohet e paditura Komuna e Rahovecit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve, t’u paguaj kompensim në emër të ushqimit gjatë punës për në lartësi prej 2,00€ për një ditë pune, duke filluar prej datës 18.04.2017 e deri më datën 20.04.2021 si vijon:*

*-Paditësit të parë S.K., t’i paguaj kompensim në emër të shpenzimeve të ushqimit për gjithsejtë 655 ditë pune, në vlerë prej 2,00€ për një ditë pune, shumën prej 1.310,00€.*

*-Paditësit të dytë R.B., t’i paguaj kompensim në emër të shpenzimeve të ushqimit për gjithsejtë 646 ditë pune, në vlerë prej 2,00€ për një ditë pune, shumën prej 1.292,00€ .*

*-Paditësit të tretë R.H., t’i paguaj kompensim në emër të shpenzimeve të ushqimit për gjithsejtë 646 ditë pune, në vlerë prej 2,00€ për një ditë pune, shumën prej 1.292,00€.*

*-Padiësit të katërt S.M., t'i paguaj kompensim në emër të shpenzimeve të ushqimit për gjithsejtë 561 ditë pune, në vlerë prej 2,00€ për një ditë pune, shumën prej 1.122,00€, respektivisht shumën prej 170,00€, e refuzoj si të pa bazë.*

*-Padiësës së pestë H.D., t'i paguaj kompensim në emër të shpenzimeve të ushqimit për gjithsejtë 646 ditë pune, në vlerë prej 2,00€ për një ditë pune, shumën prej 1.292,00€*

*Padiësit të gjashtë V.D., t'i paguaj kompensim në emër të shpenzimeve të ushqimit për gjithsejtë 646 ditë pune, në vlerë prej 2,00€ për një ditë pune, shumën prej 1,292,00€ , apo gjithsejtë për të gjithë padiësit 7.600,00€, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së marrjes së këtij aktgjykimi (19.05.2021), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm, si me bazë.*

*Detyrohet e paditura që në po të njëjtën afat, padiësit t'i paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej 1,713,00€ me kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm “.*

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur pala e paditur, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës me aktgjykim të aprovoj ankesën e paraqitur në atë mënyrë që ta ndryshoj aktgjykimin e goditur duke e refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e padiësve ose Gjykata e Apelit me aktvendim të aprovoj ankesën dhe të prish në tërësi aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Përfaqësuesi i padiësve në anën tjetër e ka paraqit përgjigje në ankesë, me propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet e pa bazuar ndërsa aktgjykim i atakuar të vërtetohet, si dhe të detyrohet e paditura që padiësve në mënyrë solidarë, t'ua kompensoj edhe shpenzimet procedurale përfshirë edhe ato të përgjigjes në ankesë sipas tarifave të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 dhe 195 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjeti se:

#### **Ankesa e së paditurës është e pa bazuar .**

Nga shkresat e lëndës rezulton se: padiësit përmes të autorizuarit të tyre kanë paraqitur padi kundër të paditurës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit.

I autorizuari i padiësve ka mbete në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe në parashtrësën mbi precizimin e kërkesëpadisë të datës 15.03.2021, duke kërkuar që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e padiësve ashtu që të detyrohet e paditura Komuna e Rahovecit-Drejtoria Komunale e Arsimit që padiësve secilit veç e veç t'ia paguaj, kompensimin për ushqim-shujtave ditore për ditët dhe shumat e specifikuara, e të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur nga prej ditës së marrjes së këtij aktgjykimi (19.05.2021), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm. Të detyrohet e paditura që në po të njëjtën afat, padiësve t'u paguaj edhe shpenzimet procedurale.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të padisë dhe provave, me aktgjykimin e atakuar, ka vendosur që ta aprovoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Siç shihet në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, nga gjykata e shkallës së parë është gjetur mbështetje në provat të cilat i ka pasur në dispozicion, duke theksuar se kjo e drejtë u takon paditësve në bazë të dispozitave të cekura në aktgjykim, ku ceken dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, duke konsideruar se e paditura obligohet që këto shpenzime të ua paguaj paditësve, sikurse në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar. Konkludimin e saj, gjykata e shkallës së parë e ka nxjerrë nga provat, siç janë Kontratat e punës për secilin paditës dhe vërtetimet e paditësve për prezencën e tyre në punë dhe të gjitha të bazuara në Kontratën e Arsimit në Kosovë.

Për mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë është bazuar në nenin 35.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit, nenin 382 të LMD-së si dhe nenin 452.1 të LPK-së dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të përfaqësuesit të autorizuar të paditurës, se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së, se aktgjykimi është në kundërshtim me arsyetimin. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se, gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, sa i përket marrëdhënies së punës-përvojës në punë të secilës nga paditëset, në shkollën përkatëse, si dhe ditëve të pranisë në punë të secilës prej tyre veç e veç, se nuk është kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse, se paditëset janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe atë nga data 18.04.2017 kur edhe ka hy në fuqi Kontrata Kolektive e deri me dt. 20.04.2021 kanë qenë në vendin e punës dhe atë në ditët e precizuara për secilën paditës veç e veç. Po ashtu nuk është kontestuese se secila nga paditësit për periudhën kohore 18.04.2017 deri me datën 20.04.2021, ka gjithsejtë ditë pune, të specifikuar me detajisht si në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar.

Pra, nuk është kontestuese se paditësit tek e paditura kanë përvojë të punës dhe prezenca e secilit prej tyre në punë, ka qenë si në periudhën e sipër cekur kontestuese, si në provat e bashkangjitura, e për të cilën periudhë me të drejtë e kanë kërkuar kompensimin e shpenzimeve të ushqimit-shujtës.

Gjykata e Apelit vlerëson se, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se:

Me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 5 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”*.

Me nenin 35 paragraf 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, përcaktohet se: *“ Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*.

Me nenin 46 paragrafi 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: *“MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht për ti informuar dhe ndihmuar komunitetet që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafët 5, 7 dhe 9”*. Kështu që edhe pretendimi ankimor i palës së paditur në këtë aspekt, nuk është i bazuar.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëseve, duke e detyruar të paditurën që paditësve në emër të shpenzimeve të ushqimit-shujtës me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe se e njëjta është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditëseve në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit-shujtës, gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“ Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Gjykata e Apelit vlerëson se e paditura ka për detyrim të paguajë shpenzimet e ushqimit, kuptohet për punëtorët të cilët i plotësojnë kushtet e kërkuara me Kontratën kolektive e cila ka qenë në zbatim në kohën e prezencës në vendin e punës të paditësve. Sipas vlerësimit të gjykatës ankimore me dispozitën e nenit 2 paragrafi 1 pika 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 përcaktohet se:

1. *“Dispozitat e kësaj kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”, ndërsa me nën paragrafin 1.2 përcaktohet se: “Dispozitat e kësaj kontrate, janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”.*

Nga interpretimi i këtyre dispozitave Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret është obligim i të gjitha institucionet edukativo-arsimore publike dhe private të zbatojnë këtë kontratë, pasi që e njëjta është nënshkruar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK-ut, prej së cilës rrjedhin detyrime të cilat është e obliguar e paditura ti përmbushë, gjegjësisht përgjegjësia për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit bien të paditurën e cila është e detyruar ta përmbushë një detyrim të tillë, andaj edhe një pretendim i tillë rezulton të jetë i pathemeltë të cilin gjykata ankimore vendosi ta refuzojë.

Edhe në vendimin sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 paragraf 1 dhe 2 i LMD-së, me nr. 04/L-077 i datës 30.05.2012, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20.12.2012.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.10227/21, me datë 03.10.2022

Kryetari i kolegjit Gjykatësi  
Gëzim Lulluni